



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.11.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik "LEDIONI GROUP" SH.P.K.. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe sanimi i urave në Has, Rekë të Mirë, Rekë të Keqe dhe Dushkajë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6343-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-085 -521, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori ekonomik "LEDIONI GROUP" SH.P.K.. e dt.13.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe sanimi i urave në Has, Rekë të Mirë, Rekë të Keqe dhe Dushkajë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6343-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-085 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 08.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 08.11.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.



Arsyetim

Operatori ekonomik "LEDIONI GROUP" SH.P.K.. me dt.13.11.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe sanimi i urave në Has, Rekë të Mirë, Rekë të Keqe dhe Dushkajë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6343-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-085 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse oferta juaj nuk është pranuar sepse ju nuk keni plotësuar listën e kontratave të realizuara sipas formës së listës në Aneksin 6 të FDT-së. Gjithashtu sqarohet se me frazën: "ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë" është fjala për atë se në vend të certifikatave përkatëse mund të prezantohet ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë(referenca,raport i pranimit teknik ej).

Pretendimi tjetër i juaj se pse nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë lidhur me këtë, prape nuk qëndron, sepse plotësimi i listën e kontratave të realizuara sipas formës së listës në Aneksin 6 të FDT-së, ka qenë obligativ, prandaj nuk janë kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së.

Pretendimi juaj se kontrata i është dhënë Operatorit ekonomik me çmim më të lartë se ju, nuk qëndron sepse Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë Operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

